



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT

*Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit
Financiar dhe Auditimit të Brendshëm*

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUTIN E
SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shqërore, me objekt “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, miratuar me Vendim nr. 81, datë 30.06.2014 të Kryetarit të KLSH, i janë përcjellë subjektit të audituar me shkresën nr. 177/8, datë 30.06.2014.

Nga auditimi është konstatuar se institucioni ka ndjekur dhe respektuar çdo muaj kufijtë e programuar të fondeve për transferuat në buxhetet familjare sipas programimit dhe limiteve të miratuar me ligjin e buxhetit të vitit 2013. Shpenzimet kanë ndjekur dhe respektuar kuotat e fondeve limit të çelura për çdo skemë dhe çdo drejtori rajonale të ISSH. Konstatohet se skema aktuale e sigurimeve shoqërore shfaq problematika si në procesin e realizimit të të ardhurave dhe në realizimin e shpenzimeve, të shoqëruara me rritje nga viti në vit të subvencionimet buxhetore. Gjatë auditimit të praktikave dokumentare (evidencave, formularëve si dhe raportit të vitit 2013) të vëna në dispozicion nga ISSH-ja, kemi konstatuar:

1. Mos realizim të të ardhurave të programuara nga shmangia e pagesës së kontributeve nga punëdhënësit për të punësuarit e tyre në subjektet juridikë dhe fizik. Konstatohet një nivel kontributiv më i ulët me efekte në të ardhura, evazion që ka sjellë që plani vjetor fillestar i të ardhurave prej 48,918 milion lekë të realizohet vetëm 98.73 % duke krijuar një deficit në të ardhura me 622 milion lekë. Deficiti i mësipërm, referuar analizave është krijuar nga mosrealizimi i numrit të kontribuesve, që vjen nga mosrealizimi i numrit të programuara të kontribuesve, numri i ulët i kontribuesve për një subjekt si dhe rritje e numrit të punonjësve me pagë minimale, të cilat kanë sjellë një nivel të lartë të evazionit fiskal, me pasojë krijimin e një deficiti të konsiderueshëm në skemën e sigurimeve shoqërore.

2. Kemi konstatuar rritje të detyrimeve të papaguara ndaj skemës së sigurimeve me rreth 1,9 miliardë lekë, vetëm për vitin 2013 kjo ka sjellë që stoku i detyrimeve kontributive të papaguara nga subjektet juridik dhe fizikë në fund të vitit 2013 të arrijë në 10 miliardë lekë. Këto detyrime përfaqësojnë, kontribute, interesat dhe gjokat e papaguara, dhe përbëjnë rreth 21% të totalit të të ardhurave të planifikuara.

3. Lidhur me mbledhjen e kontributeve, problem shqetësues është mosdorëzimi i listëpagesave nga subjektet e biznesit të madh dhe të biznesit të vogël, sidomos ato të biznesit të vogël. Llogaritet që nga 749,320 listëpagesa që duhet të vinin në format elektronik pranë ISSH, kanë mbërritur vetëm 64,500 listëpagesa. Kjo problematikë lidhet me vlerësimin e drejtë të të ardhurave të konstatuara për periudhën për skemën e sigurimeve por pa anashkaluar problemin e madh social, në fushën e sigurimeve shoqërore, sepse nga mospagesat e kontributeve, pasi shumë personave mbeten jashtë të qenit subjekt i ligjit të sigurimeve shoqërore duke mos përfituar prej tij.

4. Auditimi konstatoj tendencën në rënie të numrit fizik të kontribuesve, të siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht realizimit të fondeve të planifikuara për tu mbledhur nga vetë ISSH. Nga institucioni, theksohet se faktori që ka influencuar në rënien e numrit të

kontribuesve është tërheqja nga skema e rreth 46,000 persona, të cilët kanë plotësuar vjetërsinë e nevojshme prej 35 vitesh sigurim dhe nuk paraqesin interes për sigurim, sepse nuk përfitojnë shtesë pensioni. Skemës së sigurimeve shoqërore në fshat i mungon një numër relativisht i lartë i personash, që për vitin 2013 vlerësohen të jenë 113,377.

Nga auditimi i shpenzimeve për buxhetin e Sigurimeve Shoqërore rezultoi se programi përfundimtar i shpenzimeve i miratuara me ligjin për buxhetin e vitit 2013, nga 95,395 milionë leke të programuara është realizuar në shumën 95,596.6 milionë leke, me një tejkalim prej + 201.6 milionë krahasuar me planin ose 100.2%. Të ndara sipas programeve, shpenzimet e vitit 2013 janë realizuar si me poshtë:

- 1. Shpenzimet për skemën e detyrueshme, ku përfshihen shpenzimet për përfitime nga ligji i sigurimeve shoqërore, janë realizuar në masën 100.4 % me një tejkalim referuar planit në shumën 298.9 milionë leke,*
- 2. Shpenzimet për programe të veçanta të Qeverisë lidhur me shpërblime nga statute, skemat kompensuese dhe shpenzimet e administrimit të tyre, janë realizuar në masën 99.9 %, me një mos realizim në shumën 5.9 milionë leke.*
- 3. Shpenzimet për skemat suplementare dhe shpenzimet për administrimin e tyre, janë realizuar 99.7 % ose me një mos realizim prej 15.1 milionë leke krahasuar me planin.*
- 4. Shpenzimet administrative, nga 2,049.2 milionë leke të programuara janë shpenzuar 1,972.9 milionë leke, realizuar në masën 96.3 %, me një mos realizim prej 76,3 milionë leke.*

Mbi Deficitin e Degës së Pensioneve. Bazuar në nenin 67 të ligjit nr 7703, datë 1.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, shpenzimet për skemën e Sigurimeve Shoqërore financohen nga fondi i Sigurimeve Shoqërore i cili krijohet nga kontributet, të ardhurat e tjera, financimet dhe subvencionet buxhetore shtetërore. Që, në fazën e hartimit të projekt-buxhetit të vitit 2013 por edhe të buxheteve faktike të viteve të mëparshme dega e pensioneve ka rezultuar me deficit, pasi të ardhura janë më të vogla se shpenzimet që duhen për të mbuluar pagesat e pensioneve. Për të balancuar buxhetin e degës së pensioneve, ky deficit mbulohet nga transfertat buxhetore të miratuara me ligjin për buxhetet vjetore. Për vitin 2013, ka rezultuar se shpenzimet për degën e pensioneve zënë 80.4 % të totalit të shpenzimeve të realizuara për këtë vit, kundrejt 79.7 % të volumit total të shpenzimeve të sigurimeve shoqërore për vitin 2012. *Duke e krahasuar rezultatin financiar të kësaj dege për disa vite, rezulton se deficit i degës së pensioneve është thelluar nga viti në vit dhe bazuar në treguesit e buxhetit afatmesëm, parashikohet të thellohet edhe në tre vitet e ardhshme, duke bërë të domosdoshme marrjen e masave konkrete dhe reformimin e Sistemit të Sigurimeve Shoqërore.*

Argumentojmë që në harkun kohor të 2010-2013, vetëm deficit i degës së pensioneve ka një trend rritës nga 1.03 % kundrejt PBB-së që rezultoi në vitin 2010, arriti në 1.67 % të PBB-së në vitin 2013. I shprehur në terma nominale, ky deficit në fund të vitit 2010 rezultoi 12.5 miliardë lekë duke arritur në 22.6 miliardë lekë në fund të vitit 2013 duke shënuar një thellim të ndjeshëm të deficitit me rreth 10 miliardë leke në harkun kohor të katër viteve. Sa më sipër kemi konkluduar se në 4 vitet e fundit mbulimi i shpenzimeve për degën e pensioneve me kontributet e degës, ka qenë gjithnjë me **i vogël se ritmi i rritjes së shpenzimeve** duke e thelluar deficitin financiar të kësaj dege.

Edhe pse deficit i degës së pensioneve ka qenë mjaft i lartë në të 4 vitet, rritja e pensioneve nuk është bërë sipas rritjes së indeksit të çmimeve por është përcaktuar me VKM sipas mundësive (ose politikave) të buxhetit të shtetit për mbulimin me fonde të efekteve financiare të atij viti. Këto veprime ndërsa kanë reflektuar një rritje të të ardhurave të pensionistëve, kanë thelluar deficitin e degës së pensioneve në një periudhë afatgjatë. Aktualisht deficit paraqitet mjaft i lartë dhe për vitin 2013 arriti në 1.67 % të prodhimit të brendshëm bruto. Një

faktor tjetër me rëndësi që ka ndikuar në thellimin e deficitit është edhe evazioni (shmangia nga pagesat e kontributeve). Për vitin 2013, bazuar në të dhënat e INSTAT, “**Bilanci i forcave të punës**” të krahasuara me të dhënat e INSTAT për “**Të punësuarit sipas degëve**” si dhe me të dhënat e **Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve** për numrin e kontribuesve në aktivitetet jo bujqësore për vitin 2013, rezulton se diferenca midis të punësuarve dhe atyre që nuk kane paguar kontribute është rreth 61,000 persona. Pra konstatohet një evazion fiskal në numrin e raportuar si të punësuar.

Bazuar në sa më sipër në fund të këtij misioni auditimi kemi rekomanduar:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Në vitet e fundit evidentohet një rritje e ndjeshme e nivelit të borxheve, pra kontributeve të llogaritura nga organet tatimore por të papaguara ku për vitin 2013 niveli borxhit progresiv ka arritur në 9,969 milionë lekë me një shtesë në vitin 2013 me 1,915 milionë lekë, e cila përben edhe një shkak tjetër mjaft të rëndësishëm që ka ndikuar në thellimin e deficitit. Sa më sipër është emergjente dhe marrja e masave të menjehershme me impakt shumë dimensional, qoftë në drejtim të vendosjes të kriterëve sa më të drejta dhe krahasuese për palët përfituese, ashtu dhe masave për një administrim sa më eficient të fondit të sigurimeve shoqërore si dhe fondeve subvencion që buxheti i shtetit akordon në mënyrë të përvitëshme për mbulimin e skemave sipas përcaktimeve ligjore. *Rekomandimet e KLSH-se të lëna si në drejtim të përmirësimeve ligjore të akteve në fuqi si dhe ndërmarrja hartimit të marrëveshjeve ndër-institucionale, ashtu dhe marrja e masave organizative brenda ISSH, synojnë dhe kanë për qëllim përmirësimin e skemës së Sigurimeve shoqërore apo marrjen e masave për ndalimin e **“hemorragjive” me efekt uljen e deficitit të buxhetit të sigurimeve.***

Referuar rezultateve të zbatimit të rekomandimeve, propozimeve të bëra për ndryshimet strategjike nga ISSH si dhe konstatimeve nga auditimi për vitin 2013, vënia e theksit për vendimmarrje në këto drejtime merr një rëndësi të veçantë. Me synimin e realizimit të vendimmarrjes në drejtimet sa më sipër, kemi **rekomanduar**

- Përcaktimi i rregullave standarde për indeksimin e masës së pensionit, duke parashikuar indeksim vetëm me inflacionin deri në vitin 2020. Ky përcaktim të jetë ligjor dhe jo ti lihet hapësirë vendimmarrjeve vjetore të qeverisë të cilat mund të jenë politike.
- Reformimin e skemave suplementare duke rritur moshën e daljes në pension si dhe duke përmirësuar formulën e llogaritjes, duke u bazuar në pagën neto dhe jo atë bruto.
- Përmirësimin ligjor lidhur me uljen e normativës së fondit rezervë në një muaj dhe vendosjen e detyrimit që kur kjo normativë nuk mund të mbulohet nga të ardhurat, ky fond të mbulohet me financime buxhetore duke u futur në rrugë planifikimi.

Menjëherë

2. Nga auditimi i **kryer mbi skemën aktuale të** përfitimit të pensioneve për fermerët në të cilën rezultojnë ndryshime në normat e interesit që duhet të derdhen kjo kategori kontribuesish me kontribuesit e tjerë, dhe që ka të bëjë me kriterin e viteve kontribut (limit ligjor) në shtet ose si i vetë punësuar, përfshi edhe vjetërsinë e punës në kooperative. Një mënyrë e tillë llogaritje dekurajon pjesëmarrjen në skemë duke paguar kontributet e detyrueshme deri në plotësimin e moshës për pension dhe më pas, daljen nga skema. Me synimin vendosjen e kriterëve për një llogaritjeje sa më të drejtë dhe inkurajuese dhe për vazhdimin e kontribuimit për këtë kategori, **rekomandojmë:**

- Rritjen e normës së kontributit për zonat rurale duke u barazuar kontributet e fermerëve me ato të zonave urbane, deri në një periudhë afatshkurtër.
- Përmirësimi i formulës së përfitimit të pensioneve të zonave rurale duke e bërë më të drejtë në krahasim me përfitimet e tjera si nga pikëpamja e viteve të domosdoshme kontribut ashtu

dhe nga niveli i shumave kontribut duke kombinuar interesin midis periudhës së sigurimit dhe masës së përfitimit, me qëllim që çdo person që punon në bujqësi të paguaj kontribute, gjatë gjithë kohës që është ekonomikisht aktivë, deri në plotësimin e moshës për pension.

Menjëherë

3. Referuar faktit se marrëveshja midis ISSH-se dhe Postës Shqiptare me nr.4537/1932, date 21.08.2008 “Për pagimin e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” duhet të ndryshonte domosdoshmërisht për shkak të aplikimit në masën më të madhe, të pagesave on-line të përfitimeve gjatë vitit 2013, për **këtë rekomandojmë:**

- Nga ISSH të ndiqen procedurat zyrtare të miratimit nga të dy palët të marrëveshjes së rishqyrtuar “Për transmetimin në format elektronik të përfitimeve të njohura dhe pagesën e këtyre përfitimeve, bazuar në sistemin on-line të ISSH me Postën Shqiptare- sha”.

Menjëherë

4. Marrë shkas nga konstatimi i mosplotësimin të detyrimeve nga DPT për dërgimin e informacionit mbi arkëtimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet sipas kërkesave të VKM Nr.1114, datë 30.07.2008, nisur dhe nga fakti se DPT po ndërton një program informatik të ri me kapacitetet e nevojshme të transferimit të këtyre të dhënave në ISSH, në lidhje me procesin e deklarimit të pagesave dhe administrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sigurimeve shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale, **rekomandojmë:**

- Nga ana e dy institucioneve të përcaktohen procedurat e dërgimit të informacionit të nevojshëm deri në përfundimin e përshtatshmërisë së sistemit të informatizimit të DPT me programin informatik pritës të të dhënave në ISSH.

- Të gjejnë zgjidhjet procedurale për bizneset me një punonjës që kanë bërë derdhjet e kontributeve por nuk kanë paraqitur listë pagesë.

- Përfundimin e aktmarrëveshjes dypalëshe me të gjitha ndryshimet e nevojshme që kanë rezultuar nga zbatimi i VKM nr.1114, datë 30.07.2008, dhe akteve që do të konkludohen nga miratimi i ndryshimeve ligjore.

Menjëherë

5. Referuar faktit të rezultuar nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë se nuk ka marrë miratimin përkatës Projektvendimi i Këshillit të Ministrave i propozuar nga ISSH në të cilin përcaktohen, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të KMCAP-et Eprorë, (me anë të konkurseve apo të shorteve) si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të këtyre komisioneve, si dhe referuar faktit të pritshmërive dhe ndryshimeve nga reforma përkatëse në sistemin e sigurimeve shoqërore, për plotësimin dhe përmirësimin e akteve në fuqi në lidhje me KMCAP-et Eprorë (për zgjedhjen e anëtarëve si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të tyre), **rekomandojmë:**

- Përfshirjen në aktet përkatëse të ndryshimit nga reforma në sigurimet shoqërore edhe të propozimeve të bëra dhe të miratuara në parim në Projektvendimin e Këshillit të Ministrave për organizimin e KMCAP Eprorë.

Menjëherë

6. Referuar konstatimit se në vitin 2013, për 161 punonjës të cilët janë trajtuar me raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë në shumën 1,230,920 lekë, nuk janë mbajtur kontributet për sigurime shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat në kundërshtim me udhëzimin nr.26, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” dhe udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe referuar faktit të konstatuar që ky fenomen është identifikuar dhe në institucione të tjera

publike, me synimin e eliminimit të interpretimeve të ndryshme nga përcaktimet në udhëzimet përkatëse **rekomandojmë:**

- Nga Drejtoria e Përgjithshme ISSH mbas ndryshimeve ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të iniciohet dalja e një Vendimi të Këshillit të Ministrave për procedurat e mbajtjes së kontributit dhe tatimit mbi të ardhurat, për raportet mjekësore, të paguar deri në 14 ditë nga punëdhënësi.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Referuar konstatimit nga auditimi, se në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet ISSH dhe DPT për transferimin e subjekteve debitorë dhe të detyrimeve të tyre të prapambetura, nga organet e sigurimeve shoqërore në organet tatimore, gjatë periudhës Janar 2006 - Dhjetor 2013, janë transferuar gjithsej 1,382 subjekte debitorë, ku me transferimet e bëra gjatë vitit 2013, është mbyllur detyra e transferimit të subjekteve në organet tatimore, si dhe referuar konstatimit se në llogaritë e organeve të sigurimeve shoqërore kanë mbetur vetëm debitorët pasivë me veprimtari të mbyllur para vitit 2005, dhe me synim sistemin e këtyre detyrimeve që janë në shumën 332 milionë leke që i përgjigjen 197 subjekteve nga të cilat 7 subjekte përbejnë 80 % të detyrimit, ku përmendi ish Kombinati Tekstileve Berat dhe Fabrika e Tullave Vorë, **rekomandojmë:**

- Marrja e nismave nga ISSH që nëpërmjet një analize përfundimtare të gjendjes së borxheve të vjetra pa shpresë arkëtimi, paraqitur Këshillit Administrativ, të përcaktojë veprimet përfundimtare ligjore si dhe afatet kohore për ndjekjen dhe mbylljen e këtij procesi.

Paraqitja e materialit në KA deri në Shtator 2014

2. Referuar faktit të rezultuar se deri në fund të muajit Dhjetor 2013, në serverin qendror të ISSH-së ishin depozituar vetëm 64,500 listë pagesa ose rreth 12 % e tyre, një shifër kjo tepër e ulët, kur për të gjithë llojet e biznesit duhet të dispononin 749,320 listë pagesa mujore dhe njëkohësisht ritmet e transferimit të të dhënave nga DPT janë mjaft të ulta, duke krijuar aktualisht problematika në njohjen e periudhave të sigurimit të kontributit pagesës. Gjithashtu theksojmë se në numrin e përgjithshëm të listë pagesave të munguara bëjnë pjesë edhe ato listë pagesa që janë të dorëzuara dhe mbahen në organet tatimore pasi i përkasin procesit të vlerësimit të detyrimeve të papaguara ose të paguara pjesërisht si dhe listë pagesat që mund të mos jenë dorëzuar nga subjektet. Numri i listë pagesave që mungojnë për vitin 2013 është bazuar në përlllogaritjen nisur nga numri i subjekteve. ISSH-ja dhe drejtoritë rajonale në rajone nuk disponojnë informacion të saktë dhe sipas subjekteve për këtë çështje pasi informacioni për listë pagesat e bllokuara për mos pagesë ose pagesë pjesore, për listë pagesat e pa dorëzuara nga subjektet si dhe për listë pagesat e rregullta por të pa transferuara në ISSH-në në rrugë elektronike nuk dërgohet dhe nuk vihet në dispozicion të Sigurimeve Sheqerore, nga organet tatimore. Nga të dhënat e evidencave rezulton se listë pagesat e munguara që i përkasin vitit 2013 zënë mbi 75% të totalit të listë pagesave, ndërkohë që nga totali i listë pagesave të munguara rreth 77% e zënë subjektet e biznesit të vogël të cilët janë subjekte të vetëpunësuar, ose duke pasur edhe një numër shumë të kufizuar të të punësuarve të cilët përgjithësisht janë anëtarë të familjes **rekomandojmë:**

- Të bëhet një ri evidentim i plotë analitik i listë pagesave të munguara, duke evidentuar shkakun e mungesës si dhe masat për grumbullimin e tyre.

Deri më 31 Tetor 2014

3. Meqenëse gjendja e borxheve nga subjektet publike është në masën 9,9 miliard lekë më 31.12.2013, ku vetëm për vitin 2013 detyrimet u rritën me 1,9 miliardë lekë dhe kjo gjendje po rëndohet në vazhdimësi, ku një nga arsyt e shtesës së detyrimeve ka qenë paaftësia pagesë e këtyre subjekteve dhe meqenëse jemi në situatën, ku qeveria po likuidon detyrimet

e papaguara të subjekteve publike në marrëdhënie me shtetin, me synimin e zvogëlimit të borxheve kundrejt sigurimeve shoqërore, **rekomandojmë**:

- Nga ana e ISSH në bashkëpunim me DPT, ti kërkohet Ministrisë së Financave që të përcaktohen procedura të tilla, që nga subjektet të cilave u rimbursohen detyrimet nga mos likuidimi i faturimeve të prapambetura, tu zbriten detyrimet në favor të sigurimeve shoqërore për pagesat e pa likuiduara nga këto subjekte për to.

Menjëherë

4. Nga auditimi i procedurave të prokurura fokusuar në parimet themelore të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, stimulimi i biznesit të vogël dhe të mesëm, barazia e kandidatëve për përdorimin efektiv të fondeve publike u konstatuan mangësi të lidhura me mungesën e harmonizimit të punës midis njësisë së hartimit të dokumentacionit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave dhe qëndrime të ndryshme teknike të këtyre strukturave, interpretime dhe keqinterpretime, të cilat ndikojnë edhe në nxitjen e ulët të konkurrencës në këto tenderime. Bazuar në këtë fakt në drejtim të përmirësimit të punës, që do të shoqërohej me një efikasitet të plotë të fondeve në arritjen e objektivave të këtij institucioni, **rekomandojmë që**:

- Nga ISSH-ja të merren masa, për të bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit Publik, nëpërmjet APP-së, për çështjet e prokurimit publik, në përmbushjes kjo të kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshime.

Vazhdimisht

5. Nga Njësia e Prokurimit Publik, për të ardhmen, të merren të gjitha masat, që kërkesat kualifikuese të veçanta, të hartohen në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit, që kërkohet të prokurohet, të vendosen kriteret të nevojshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të jenë shumë të kuptueshme deri tek bizneset e vogla si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Për kërkesat kualifikuese të miratuara, detyrimisht të kërkohen shoqërimet me dokumentet vërtetues si dhe të përcaktohen organet përkatëse, që lëshojnë dokumente të tilla vërtetuese. Gjithashtu kërkesat kualifikuese të veçanta të miratuara për konkurruesit, detyrimisht të argumentohen, duke shpjeguar arsyet përkatëse.

Vazhdimisht

6. Nga ISSH-ja, për të ardhmen, të merren të gjitha masat, që procedurat e prokurimit publik, të fillojnë që në ditët e para të muajit Janar e të vazhdojnë deri në momentin e shpalljes së fituesit, duke pritur për aq kohë, sa do të çelen fondet përkatëse.

Vazhdimisht

7. Nga KVO-të të merren masa për të ardhmen, që në procedurën e tenderit të përdorur “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, të bëhen negociimet përkatëse me operatorët ekonomik konkurrues duke kaluar me rigorozitet të gjitha hapat që janë përcaktuar. Kjo në respektim të legjislacionit të prokurimit publik, e konkretisht të Manualit të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 3.2, që cilëson mes të tjerave: “Negociohet me Ofertuesit e Kualifikuar të Seleksionuar si dhe për çdo veprim të kryer duhet regjistruar në procesverbalin përkatës”.

Vazhdimisht

8. Referuar konstatimit që dokumentacioni standard i arkës nuk ishte konfirmuar nga të gjithë punonjësit që përcakton dokumentacionin, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **rekomandojmë**:

- Nga strukturat përgjegjëse të administrimit të këtyre dokumenteve të merren masa për konfirmimin e tyre sipas kërkesave të udhëzimit të cituar më sipër.

9. Nisur nga konstatimi se nga Drejtoria e Përgjithshme e ISSH, janë realizuar shpenzime në shumën 963,000 lekë (dieta) për vitin 2013, për një ekspertizë të realizuar nga punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shërbim që për periudhën 2011-2013, kap vlerën 3,953,800 lekë, si dhe referuar faktit se nuk është bërë rimbursimi shumës nga ana e Prokurorisë **rekomandojmë:**

- Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH nisur nga fakti i pa bazueshmërisë ligjore të kryerjes së këtyre pagesave prej saj, të kërkojë domosdoshmëri nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër rimbursimin e shumave përkatëse, referuar një plan veprimi me afate për mundësi rimbursimi të menjëhershme apo dhe pjesore.

- Nga Drejtoria e Përgjithshme në vendimmarrje të tjera të këtij lloji të hartohen dhe miratohen marrëveshje paraprake midis institucioneve, në mbështetje të akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë

10. Referuar konstatimit që në 14 raste të blerjeve me vlera të vogla për një shumën totale 488,334 lekë, dokumentacioni shoqërues nuk ishte i plotë, në kundërshtim me Udhëzimin nr 2.datë 18.02.2008, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe konstatimit që në rastet e procedurave me blerje të vogla të konsideruara si raste të emergjencës, dokumentacioni i përdorur nuk është i miratuar, **rekomandojmë:**

- Nga strukturat përgjegjëse të administrimit të këtyre dokumenteve të merren masa për përpilimin dhe plotësimin e tyre sipas kërkesave të udhëzimeve të cituar më sipër.

Menjëherë

11. Referuar faktit që inventarizimi nuk është përfunduar brenda afatit të përcaktuar me në urdhrin nr.9906, datë 24.12.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm, kjo si pasojë e transferimit në ambientet e rikonstruara të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH në muajin Dhjetor 2013, me synim përfundimin në kohë reale të këtij procesi, **rekomandojmë:**

- Përcaktimin nga Titullari i Institucionit të një afati të sa më të afërt kohor për përfundimin e inventarit dhe nxjerrjen e rezultateve të inventarizimit.

Menjëherë

12. Nisur nga konstatimi i një vlere të madhe, 3,776 milionë lekë, në pasqyrat financiare si “Kërkesa debitore”, shumë që përfaqëson debitorë të pakontestueshëm dhe debitorë në proces verifikimi (gjyqe, ndjekje penale, rezultate rivlerësimi përfitimesh, rezultate auditimi), me synim ndjekjen në vijimësi dhe në mënyrë të përqendruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, **rekomandojmë:**

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e ISSH, në Drejtorinë e Financës të përfshihet dhe funksioni i mbajtjes dhe përditësimit të Database-it të debitorëve të kësaj kategorie, duke ndjekur progresivisht procesin e shlyerjes së detyrimeve dhe bërjes prezent pranë menaxhimit të lartë, të problematikës së rezultuar në këtë proces hap pas hapi.

Menjëherë

13. Në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm rezulton se është emëruar një auditues duke mos qenë i pajisur me certifikatën e Auditit të Brendshëm, në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 10138, datë 16.09.2010, neni 19, për këtë **rekomandojmë:**

- Nga ISSH, struktura e DAB të merren masat që të gjithë punonjësit funksional të kësaj drejtorie të jenë të pajisur me certifikatën e audituesit, konform kërkesave të ligjit.

Vazhdimisht

14. Nisur nga konstatimi se dy punonjës auditues janë pushuar në kuadrin e ristrukturimit të njësisë së auditimit të brendshëm në kundërshtim me nenin 143/1 të Kodit të punës, si dhe faktit të zëvendësimit të punonjësve që përmbushnin kriteret ligjore për auditues të brendshëm me auditues që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 10138, datë 16.09.2010, **rekomandojmë:**

- Nga ISSH të analizohet dhe të kryhet vlerësimi i statusit dhe punës së audituesve të Njësisë së auditimit të brendshëm referuar kriterëve të vjetërsisë, profesionalizmit, trajnimeve, të kapaciteteve audituese, të disponimit dhe marrjes së dëshmisë së audituesit të brendshëm në sektorin publik dhe mbi këtë bazë të merren masat e nevojshme korrektuese për respektimin e kriterëve ligjore të punësimit dhe ushtrimit të veprimtarisë audituese.

Menjëherë

15. Nga auditimi i dosjeve të DRSSH-ve, rezultoi se në këto dosje, nuk është administruar programi i ndarjes së detyrave për çdo auditues, si dhe nuk është e dokumentuar mbikqyrja e punës audituese sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm (gjurmët e auditimit). Nuk është bërë inventarizimi i dosjeve, në përputhje me kërkesat Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, **rekomandojmë :**

- Në dosjet e auditimit, të administrohet rregullisht dokumentacioni mbi ndarjen e pikave të programit midis anëtarëve të misionit të auditimit.

- Në dosjet e auditimit të vendosen gjurmët e rishikimit nga drejtori i njësisë për kontrollin e cilësisë sipas përcaktimit në kërkesat e pikës 21, të Formatit 14 të Manualit të Auditit të Brendshëm.

- Për çdo dosje, duhet të kryhet inventarizimi i brendshëm i saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr.8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Menjëherë

16. Referuar konstatimit nga auditimi në DRSSH Tiranë sipas programit të auditimit nr.6981, datë 29.07.2013 për pagesat e kryera në Qendrën Postare nr.8, ku kanë rezultuar të meta dhe diferenca konsideruar si dem ekonomik si dhe referuar faktit se për përgjegjësitë e caktuara sa më sipër për Z. [REDAKTUAR] në rekomandimet përkatëse nuk ka gjurmë në material si dhe gjurmë për përputhshmërinë e funksioneve të tij të caktuara në emërimin si dhe përshkrimin e vendit të punës me konstatimet nga auditimi, **rekomandojmë:**

- Nga DAB, të bëhet përputhshmëria e gjetjeve nga auditimi me përgjegjësinë funksionale të Z. [REDAKTUAR] referuar funksioneve dhe detyrave të vendit të punës, dhe referuar sa më sipër konkludimi për saktësinë e masës disiplinore të dhënë “Largim nga detyra”.

17. Referuar konstatimit se, në Rregulloren e Këshillit Administrativ “Për funksionimin e Këshillit Administrativ të ISSH-së” të miratuar në vitin 1996, nuk është bërë azhurnimi i bazës nënligjore në Rregulloren përkatëse, ku Statuti i ISSH-së, i miratuar me VKM nr.161, datë 11.04.1994, ka ndryshuar me VKM nr.1022, datë 09.07.2008, **rekomandojmë:**

- Të bëhen përmirësime në Rregulloren nr.1, datë 30.04.1996, të Këshillit Administrativ, sipas përcaktimeve në aktet e ndryshuara.

Menjëherë

18. Nga auditimi i nivelit të punimeve të realizuara, për tenderin me objekt “Rikonstruksion i Institutit të Sigurimeve Shëndetësore”, është konstatuar se për zërin “Vetratë gjysëmstrukturale me xham triplex 3+3 mm”, materiali i vendosur nuk është sipas përcaktimeve në kërkesat e vendosura të tenderit, prandaj **rekomandojmë:**

- Autoritetit Kontraktor, në bashkëpunim me mbikëqyrësen e punimeve, të verifikojë me përgjegjësi ligjore vërtetësinë e materialit të përdorur, sipas certifikatës së konformitetit për zërin e punës “Vetratë gjysëmstrukturale me xham triplex 3 + 3 mm”. Pas këtij verifikimi, të bëhet rivlerësimi i dëmit ekonomik prej 351,648 lekë dhe arkëtimi i tij.

Menjëherë

C.MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Për rastet e dublimeve të pensioneve, të kontabilizohen dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e demit të konstatuar në shumën **12,849,768 lekë** dhe të përfituar padrejtësisht nga përfituesit e skemës së pensioneve, ku sipas përcaktimeve në nenin 62, pika 3, të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993, ndalesa bëhet në masen 50% të kështit mujor të përfitimit të pensionit.

2. Referuar konstatimit se Posta Shqiptare në mbështetje të pikës 7 dhe 12 të kapitullit III të marrëveshjes midis dy institucioneve me nr. 4537/1932, datë 21.08.2008, nuk i ka shlyer ISSH detyrimet për fondet e pensioneve, të dëmtuara, në vlerën totale prej **295,162,639 lekë**, **rekomandojmë :**

- Nga ISSH në bashkëveprim me Postën Shqiptare të hartohet një programim afatshkurtër kohor i derdhjes së fondeve të dëmtuara nga kjo e fundit, sipas shumës së përcaktuar në vendimin e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në rastet e kundërshtive, mbajten e shumave të dëmtuara nga komisioni i shërbimit në mbështetje të pikës 7 dhe 12 të kapitullit III të marrëveshjes midis dy institucioneve të cituar sa më sipër.

Menjëherë

3. Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e demit prej 134,404 lekë, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë [REDAKTUAR], për punime të pakryera në objektin “Rikonstruksion i Institutit të Sigurimeve Shëndetësore”.

4. Të kontabilizohen dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumave të përfituara padrejtësisht si më poshtë:

a. Për shumën 457,695 lekë përfituar nga 37 punonjës në kundërshtim me VKM nr.66, datë 7.2.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr.146, datë 26.2.1998, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, Urdhrin nr.125, datë 26.12.2011 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për miratimin e hartave të azhurnuara të rrjetit rrugor e kombëtar dhe të distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë” dhe VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”

b. Për shumën 37,000 lekë, përfituar nga 3 punonjës, në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

Për këtë auditim, KLSH, ka bërë kallëzim penal me Nr.524/8 datë 15.09.2014 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 12 persona, për konsumimin e elementeve të veprave penale “mashttrim” dhe “falsifikim i dokumentave”, duke i shkaktuar një dëm shtetit në vlerën **12,849,768 lekë**.